



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE

DREJTORIA GJYQËSORE DHE E DOKUMENTACIONIT

SH P A L L J E

Në datën **22.09.2026, ora 10:00** Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë do të zhvillojë seancën plenare mbi bazë dokumentesh për kërkesën e kërkuetit Myrshit Vorpsi, me objekt: “*Shfuqizimin e vendimeve nr.00-2025-2375, datë 03.06.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe nr. 1975 (86-2024-2151), datë 19.11.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit me tjetër trup gjykues*”, dhe subjekte të interesuara Këshilli i Ministrave, Ministria a Brendshme, Bashkia Tiranë, Beqir Fetishaj, Mintosh Fetishaj, Ëngjëllushe Burreli, Xhemile, Fetishaj, Lindita Kalushi, Lirir Koleci, Dallëndyshe Latifi, Gëzim Fetishaj, Seladin Fetishaj, Arian Fetishaj, Zyra Fetishaj.

Për subjektet e interesuara në këtë gjykim **Beqir Fetishaj**, me adresë: *Rruga “Skënder Kosturi”, Tiranë, Gëzim Fetishaj*, me adresë: *Rruga “Skënder Kosturi”, Tiranë, Lindita Kallushi*, me adresë: *Rruga “Skënder Kosturi”, Tiranë, Mintosh Fetishaj*, me adresë: *Rruga “Skënder Kosturi”, Tiranë, Dallëndyshe Latifi*, me adresë: *Rruga “Skënder Kosturi”, Tiranë, Liri Koleci*, me adresë: *Rruga “Skënder Kosturi”, Tiranë dhe Xhemile Fetishaj*, me adresë: *Rruga “Skënder Kosturi”, bazuar në nenin 38, pika 3, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenet 133/a dhe 133/b të Kodit të Procedurës Civile, duke qenë se vendqëndrimi i këtyre subjekteve të interesuara nuk është i saktë, bëjmë këtë shpallje.*

Tiranë, më 15.06.2026